

RAPORT VJETOR I KONSULTIMIT PUBLIK PËR VITIN 2025, PËR AUTORITETIN KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE (AKSK)

1.Përmbledhja ekzekutive *(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)*

Gjatë vitit 2025, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) ka zhvilluar një proces të strukturuar dhe gjithëpërfshirës konsultimi publik për aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurisë kibernetike dhe identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara. Konsultimet janë realizuar përmes Regjistrisë Elektronike për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENJK), publikimit në faqen zyrtare të Autoritetit, si dhe organizimit të takimeve konsultative me grupet e interesit në institucion (AKSK) dhe aktivitetet në prezantimin e projekt aktit.

Në total, AKSK ka kryer procesin e konsultimit publik për një projektligj (Projektligjin “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe Portofolin e Identitetit Digjital”) dhe disa akte nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr.25/2024 “Për sigurinë kibernetike”, duke përfshirë strategji kombëtare, vendime të Këshillit të Ministrave lidhur me vlerësimin dhe analizimin e sigurisë kibernetike, përmbajtjen dhe dokumentimin e masave të sigurisë kibernetike, menaxhimin e krizës kibernetike, skemës kombëtare të certifikimit të sigurisë kibernetike etj.

Gjatë vitit 2025, janë konsultuar dhe miratuar 2 (dy) projekte:

- Projektvendimi “Për miratimin e skemës kombëtare të certifikimit të sigurisë kibernetike”,
- Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Planit të Veprimit.

Procesi i konsultimit ka kontribuar në rritjen e cilësisë së akteve të hartuara nëpërmjet marrjes së komenteve dhe sugjerimeve, në identifikimin e çështjeve praktike të zbatimit dhe në forcimin e transparencës dhe besimit ndërmjet institucionit dhe palëve të interesuara. Sfidat kryesore ka qenë kompleksiteti teknik i akteve dhe nevoja për kapacitete të specializuara lidhur me hartimin e këtyre akteve.

2.Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Gjatë vitit 2025, janë miratuar gjithsej 12 akte nënligjore në zbatim të ligjit nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Janë konsultuar dhe miratuar, në total 2 (dy) projektvendime, gjatë vitit 2025, si më poshtë vijon:

- Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike 2025–2030 dhe planit të veprimit 2025–2027”,
- Projektvendimi “Për miratimin e skemës kombëtare të certifikimit të sigurisë kibernetike.

Duke marrë në konsideratë natyrën, rëndësinë dhe ndikimin e secilit akt, konsultimet publike janë realizuar vetëm për ato akte që kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë dhe të konsiderueshëm mbi një numër të gjerë subjektesh të prekura. Për këto akte, për shkak të peshës rregullatore dhe efekteve konkrete në zbatim, janë organizuar konsultime të dedikuara dhe të synuara, të cilat kanë mundësuar përfshirjen efektive të palëve të interesuara dhe shqyrtimin në mënyrë të strukturuar të vlerësimeve dhe komenteve të tyre përpara miratimit përfundimtar.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Nuk ka patur ligje të miratuara, ndaj nuk ka patur raporte VNR.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përfshirjet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Nuk ka patur.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

- 2 (dy) projektvendime të Këshillit të Ministrave

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Situata paraqet përmirësim në krahasim me vitin e kaluar, si në numrin e konsultimeve, ashtu edhe në cilësinë dhe shtrirjen e tyre.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. *Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)*

Metodat më të përdorura të konsultimit gjatë vitit 2025 kanë qenë:

- Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENJK);
- Publikimi në faqen zyrtare të AKSK-së;
- Takime konsultative fizike me grupet e interesit;
- Njoftime dhe komunikim përmes postës elektronike dhe shkresave zyrtare.

2.2.2. *Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

Takimet konsultative fizike dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me grupet e interesit kanë gjeneruar numrin më të madh dhe më cilësor të komenteve.

2.2.3. *A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?*

Jo, institucioni nuk ka realizuar konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit të projekt akteve.

Në mënyrë të përmbledhur, metodat e ndjekura për secilin akt, të konsultuar dhe të miratuar, kanë qenë si vijon:

- Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030 dhe plani i veprimit 2025–2027 (VKM nr. 606, datë 23.10.2025): publikim për konsultim në RENJK (29.5.2025–26.6.2025) dhe paralelisht publikim në faqen zyrtare të AKSK-së, me mundësi për paraqitjen e komenteve me shkrim.
- VKM nr. 813, datë 30.12.2025, “Për miratimin e skemës kombëtare të certifikimit të sigurisë kibernetike”: publikim i projektvendimit për konsultim në faqen zyrtare të AKSK-së në datën 27.5.2025, si dhe organizim i takimeve konsultative fizike në datat 4 dhe 5 qershor 2025, me pjesëmarrjen e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, institucioneve publike, subjekteve private TIK, ekspertëve të pavarur dhe autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e skemës, të njoftuar nëpërmjet shkresave zyrtare dhe me email.

2.3. ***Kohëzgjatja e konsultimeve***

2.3.1. *Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?*

Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030 dhe plani i veprimit 2025–2027 (VKM nr. 606, datë 23.10.2025) është publikuar për konsultim në RENJK (29.5.2025–26.6.2025).

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

20 ditë pune për aktin e publikuar në RENJK. Ndërsa për projektin tjetër, është bërë publikimi në faqen zyrtare të AKSK si dhe janë zhvilluar takime konsultative fizike 1 deri në 2 ditë.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Situata paraqet përmirësim krahasuar me vitet e mëparshme, si në respektimin e afateve, ashtu edhe në planifikimin e procesit.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Në proceset e konsultimit kanë marrë pjesë aktorë të jashtëm joqeveritarë, banka të nivelit të dytë, ekspertë individualë, kompani TIK, operatorë të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, institucione publike dhe subjekte rregullatore.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Në procesin e hartimit të projektvendimit të skemës kombëtare të sigurisë kibernetike janë përfshirë për dhënien e feedback, ekspertë të CILC (ekspertë të projektit EU cyber Balkans).

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Në takimet konsultative të zhvilluara për të dy projektet, kanë marrë pjesë 11 palë të interesuara.

2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Në takimet konsultative, struktura e kontribuuesve lidhet përgjithësisht me përfaqësues nga infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit (duke përfshirë BSH, banka të

nivelit të dytë, AKSHI, kompani që ofrojnë dhe/ose prodhojnë produkte dhe shërbime TIK, ekspertë të pavarur, përfaqësues të Identitek sha, përfaqësues nga subjekte të sektorit bankar, mikrofinanciar dhe Fintech, si dhe përfaqësues nga institucionet publike, që ofrojnë shërbime publike, elektronike.

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në tryezat e konsultimit të organizuara nga AKSK.

2.5 Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1 Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Në total, u administruan 33 komente, mesatarisht 16 komente për çdo projekt.

2.5.2 Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

- Për projektvendimin ‘Për miratimin e strategjisë kombëtare të sigurisë kibernetike 2025-2030 dhe planit të veprimit 2025-2027’, janë dërguar me email 16 komente, nga të cilët 1 është pranuar plotësisht, 4 janë pranuar pjesërisht dhe 11 janë refuzuar, të cilat janë reflektuar edhe në raportin individual të konsultimit publik.
- Lidhur me projektvendimin “Për miratimin e skemës kombëtare të sigurisë kibernetike”, janë dërguar 17 komente me email, nga të cilat 12 janë pranuar plotësisht dhe 5 janë refuzuar, të cilat janë reflektuar edhe në raportin individual të konsultimit publik.

2.5.3 Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Vlerësohet se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në procesin e konsultimit, të organizuar nga ministria. Gjithashtu, një tjetër tregues rezulton dhe nga monitorimi i faqes së Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, pasi vërehet një rritje e numrit të qytetarëve që ndjekin projekt aktet e publikuara në të.

2.5.4 Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Nuk ka patur raporte të VNR.

2.6 **Raportet mbi rezultatet e konsultimit**

2.6.1 *Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

Në RENJK janë publikuar dy raportet individuale të konsultimit publik, për të dytre aktet e konsultuara gjatë vitit 2025: për projektligjin “Për identifikimin elektronik, shërbimet e besuara dhe Portofolin e Identitetit Digjital”, për projektvendimin ‘Për miratimin e strategjisë kombëtare për sigurinë kibernetike 2025-2030 dhe planit të veprimit 2025-2027”, si dhe për projektvendimin “Për miratimin e skemës kombëtare të certifikimit sigurisë kibernetike”.

2.6.2 *Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?*

Nuk ka raporte të pa publikuara.

2.7 **Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik** (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale është 8.

3 **Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen** (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Sfidat kryesore lidhen me:

- 1.kompleksitetin teknik të akteve,
- 2.nevojën për kapacitete të specializuara,
- 3.përfshirjen më të gjerë të publikut, joekspertë
- 4.përfshirje më e gjërë e shoqërisë në konsultim për aktet që do të hartohen në të ardhmen.